

VENDIM
Nr. 15, datë 10.1.2018

MBI MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË

Në mbështetje të nenit 16; 20, gerrat “a” dhe “h”; neneve 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 59, datë 29.4.2016, bordi i ERE-s vendosi: Fillimin e procedurave për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

- Në shkresën nr. 351 prot., datë 4.5.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftkontratën mbi “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, për konsultim dhe për të marrë komente, me qëllim përmirësimin e parashikimeve të propozuara nga grupi i punës.

- Në shkresën me nr. 351/8, datë 6.6.2017 dhe shkresën me nr. 195/3, datë 24.3.2017, Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë komentet përkatëse.

- Në shkresën nr. 351/9 prot., datë 4.7.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka shprehur dakordësinë e saj lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën në nr. 351/1, datë 17.5.2016, MZHETTS-ja ka paraqitur komentet e saj lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën me nr. 351/3 prot., datë 19.5.2016, subjekti Bashkimi i Sindikatave të Pavarura ka paraqitur sugjerimet e tij lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën nr. 351/1 prot., datë 25.5.2016, Operatori i Sistemit të Transmetimit ka paraqitur komentet e tij.

- Në shkresën me nr. 351/2 prot., datë 17.5.2016, Shoqata e Konsumatorit Shqiptar ka paraqitur komentet e saj lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën me nr. 429/1 prot., datë 6.6.2016, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka paraqitur 2 draftkontrata:

- Kushtet e përgjithshme të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike, për klientët familjarë;

- Kushtet e përgjithshme të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët jofamiljarë.

- Në shkresën me nr. 508 prot., datë 4.7.2016, ERE ka njoftuar të gjitha palët që kanë dërguar komente për zhvillimin e një seance dëgjimore.

- Në shkresën me nr. 195 prot., datë 27.2.2017, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të interesuara draftkontratën dhe komentet e OSHEE sh.a., lidhur me këtë draftkontratë të paraqitur pranë ERE-s, me shkresën nr. 5655 prot., datë 13.2.2017.

- Në shkresën me nr. 195/3 prot., datë 24.3.2017, Autoriteti i Konkurrencës konfirmon se draftkontrata mbi “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë” nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Në shkresën me nr. 195/1 prot., datë 9.3.2017, subjekti Bashkimi i Sindikatave të Pavarura ka paraqitur të njëjtat sugjerime si në shkresën nr. 351/3 prot., datë 19.5.2016.

- Në shkresën me nr. 195/4 prot., datë 29.3.2017, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka shprehur komentet e saj lidhur me propozimet e OSHEE sh.a., mbi ristrukturimin e draftkontratës.

- ERE ka analizuar të gjitha komentet e dërguara nga palët dhe ka i reflektuar në draftkontratë ato komente që i ka gjykuar të arsyeshme, në diskutim me palët, e që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti